



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:006602

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05554722

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtaren Blerina KURTAJ, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses K- Distrikti në Gjakovë (më tutje KEDS), të cilën sipas autorizimit e përfaqëson T.G., jurist në Zyrën Ligjore, kundër të paditurit U.K., nga fsh. ... Komuna Gjakovë, për kompensim dëmi material, vlera e kontestit 1,348.10 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të të paditurit, me datë 08 Prill 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses K-d- Prishtinë - Distrikti në Gjakovë.

II. DETYROHET i padituri U.K., nga fsh. ... Komuna Gjakovë, që paditëses K- Sh.a (... – Prishtinë - Distrikti në Gjakovë, në emër të kompensimit të dëmit material t'ia paguaj shumën prej 1,348.10 €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë (08.01.2021), deri në pagimin definitiv, si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 20,00 €, e gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Historiku procedural dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja, me datën 08.01.2021 në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurës për shkak të kompensimit të dëmit material në vlerë prej 1,348.10 €. Në padi dhe përmes të autorizuarit të saj, përgjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridiko - civile dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbetet pranë padisë dhe kërkesë padisë në vlerë prej 1,348.10 euro, dëmi është shkaktuar nga i padituri sipas pasojë e kryerjes së *veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i KPRK-së*, ku i padituri me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.140/18 të datës 21 shtator 2018, është shpallur fajtor dhe i njëjti e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës. Ka shtuar se lartësia e dëmit vërtetohet në bazë të faturës së kalkulimit me numër 102963 e datës 16 shkurt 2017, dhe faturës mbi llogaritjen e dëmit me DGJ17HP06558 e datës 16 shkurt 2017, ku shihet se llogaritja e dëmit është bërë në bazë të pajisjeve elektrike të cilat kanë qenë në momentin e konstatimit të kryerjes së keqpërdorimit të energjisë elektrike, të cilat fatura janë në pajtueshmëri të plotë me procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, e miratuar ZRRE ku të paditurit në bazë të nenit 14 të kësaj rregullore për konsumatorët familjar i është llogaritur në mënyrë retroaktive për 6 muaj që rezulton të jetë edhe vlera e kërkesë padisë. Tutje, i ka propozuar Gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar, dhe i ka kërkuar shpenzimet e taksës gjyqësore në shumë prej 20.00 euro.

Gjykata në kuptim të nenit 423.4 të LPK-së, shqyrtimin përgatitor, si dhe shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt, i cili mungesën e tij nuk e ka justifikuar në asnjë mënyrë për mos pjesëmarrjen në asnjë seancë gjyqësore.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor - publik, administroi këto prova: Aktgjykimi P.nr.140/18 i dt.21 shtator 2018, fatura e kalkulimit me numër 102963 e dt.16 shkurt 2017,i plotfuqishëm nga dt. 18.11.2018, dhe fatura mbi llogaritjen e dëmit DGJ17HP06558 e datës 16 shkurt 2017.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka vlerësuar çdo provë veç e veç, dhe të gjitha në lidhshmëri me njëra tjetrën dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, dhe si e tillë u aprovua.

Faktet

Nga provat e zbatuara u argumentua gjendja faktike siç më poshtë vijon:

Nga Aktgjykimi penal i Gjykatës Themelore në Gjakovë, me numër punues Aktgjykimi P.nr.140/18 i dt.21 shtator 2018, i plotfuqishëm nga data 16.11.2018 gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri e lartpërmendur është shpallur fajtor, për veprën penale: vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 i KPRK-së dhe gjykata në rastin konkret në kuptim të nenit 4,17 par. 1, 41, 46, 50, 51,73 dhe neni 320 të KPRK-së, si dhe neni 365, të KPPK-së, e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 300,00 €, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, ndërsa të dëmtuarën, këtu paditësen e ka udhëzuar që të drejtën e saj për kompensim të dëmit, të e realizojë në kontest të rregullt juridiko - civil. Në rastin konkret nga kjo provë e administruar me padyshim është vërtetuar baza e kërkesëpadisë lëndore.

Nga fatura e kalkulimit me numër 102963 e datës 16 shkurt 2017, dhe faturës mbi llogaritjen e dëmit me DGJ17HP06558 e datës 16 shkurt 2017, Gjykata ka vërtetuar faktin se sa i përket lartësisë të kërkesëpadisë e njëjta me padyshim është argumentuar, pasi përmes kësaj fature është konstatuar se i padituri me shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të pa autorizuar i ka shkaktuar dëm palës paditëse në vlerën prej 1.348.10 €.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Me nenin 137 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës nr.16, me datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, parashihet që “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*”, ndërsa me nenin 154 par. 1 të parashihet që “*Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë t’ia kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Në rastin konkret, i padituri në asnjë mënyrë nuk ka argumentuar se dëmi i sipërcituar i paditëses, është shkaktuar pa fajin e saj, prej nga rezulton se dëmi i palës paditëse, është shkaktuar si pasojë e veprimeve kundërligjore të të paditurit për të cilat edhe është shpallur fajtor me vendim të formës së prerë në procedurë penale, dhe rrjedhimisht i njëjti është e detyruar t’ia kompensojë palës paditëse vlerën e kërkesëpadisë së bashku me shpenzimet tjera aksesore, siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 %, i referohet nenit 382 të LMD - së dhe kamata është llogaritur prej e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori sipas nenit 450.1 të LPK-së dhe suksesit në kontest, ashtu që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale iu pranua shuma prej 20,00 €, në emër të taksës gjyqësore të paguar për padi e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore).

Nga të lart cituarat, e në kuptim të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

2021:006602 datë, 08 Prill 2024

Gj y q t a r j a,
Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të te njëjtit në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.